



UNMIK



IPVQ

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE NË KOSOVË
INSTITUCIJE PRIVREMENE SAMOUPRAVE NA KOSOVU
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS	GOVERNMENT OF KOSOVO	VLADA KOSOVA
Ministria e Shëndetësisë	Ministry of Health	Ministarstvo zdravstva

RAPORT		
Data/Date/Datum:	22.08.2007	Ref.No. 10/587/07
Për/To/ Za:	Prof. Sadik Idrizi, Ministër	
Nga/From/Od:	Dr. Zef Komani, Kryeinspektor Shëndetësor	
Lënda/ Subject/Tema:	Studimi Tematik: “Ecuria e licencimit të ISHPV-ve gjatë periudhës gusht 2006 mars 2007 si dhe sfidat e këtij procesi”	
Cc/Cc:	Dr. Fadil Kryeziu, Zv. Ministër Dr. Ilir Tolaj, Sekretar Permanent Dr. Arben Cami, Drejtor i DSHSH Dr. Ilir Rrecaj, Drejtor i DZHS Dr. Haxhi Kamberi, Shef i DVP	

Të nderuar!

Gjeni të bashkangjitur Studimin Tematik “Ecuria e procesit të licencimit të ISHPV-ve gjatë periudhës gusht 2006 mars 2007 si dhe sfidat e këtij procesi” kryer nga Inspektorati Shëndetësor bazuar në neni 6. alineja (i) të Ligjit mbi Inspektoratin Shëndetësor.

Shpresojmë se ky studim do të ndihmoj në angazhimet e mëtutjeshme rreth licencimit të Institucioneve Private Shëndetësore.

Me respekt!

Ministria e Shëndetësisë
Inspektorati Shëndetësor i Kosovës

Studimi Tematik

Tema: “Ecuria e procesit të licencimit ISHPV-ve gjatë periudhës gusht 2006
mars 2007 si dhe sfidat e këtij procesi”

Autor
Dr. Time Kadrijaj
Zv. Kryeinspektorë Shëndetësorë
Dr. Shaban Osmanaj
Inspektor Shëndetësor

Mentor
Dr. Zef Komani
Kryeinspektor Shëndetësor

Prishtinë
Maj - Korrik 2007
Përmbajtja

Hyrja	4
Përmbledhja.....	4
Falënderimi.....	5
Qëllimi i hulumtimit.....	5
Hipoteza dhe Supozimet	5
Metodologjia e Përdorur	5
Analiza e rezultateve të pyetësorëve.....	5
Analiza dhe statistika e dokumentacionit të ZASHMSH-ve dhe MTI.....	17
Konkluzionet.....	18
Rekomandimet.....	18
Referenca.....	19
Domethëniet e shkurtesave.....	19
Plani i Veprimit.....	19

I. HYRJE

Kosova për shkak të sistemit shoqëror para viti '89 nuk ka pasur Institucione Private Shëndetësore. Pas këtij viti e deri më '99 për shkak të ngjarjeve të njohura mirë duke llogaritur edhe sistemin e apartedit në shëndetësi, ishte e detyruar që të zhvillonte sistemin paralel shëndetësor kuptohet atë privat. Institucionet Private Shëndetësore patën rolin vendimtar në mbrojtjen shëndetësore të tërë popullatës. Gjate kësaj periudhe u vendosen edhe themelet e veprimtarisë private shëndetësore.

Iniciativa private si në tërë sektorët ekonomik të Kosovës po ashtu edhe në shëndetësi, ka pësuar një rritje të madhe viteve të fundit. Kjo rritje e aktivitetit pas lufte ka qenë e pa monitoruar nga Ministria e Shëndetësisë ku faktori kryesor për këtë situatë ka qenë mungesa e infrastrukturës ligjore.

Me 27 shtator 2004 u miratua Ligji mbi Veprimtarinë Shëndetësore Private 2004/50, ku filloj vënia e bazës ligjore për rregullimin, kontrollimin, dhe përparimin e shërbimeve shëndetësore në këtë sektor.

II. PËRMBLEDHJA

Studimi Tematik është bërë në kuadër të obligimeve dhe detyrave për Inspektoratin, që burojnë nga Ligji për Inspektoratin Shëndetësor.

Inspektorati Shëndetësor i Kosovës u themelua në qershor të vitit 2006 në bazë të Ligjit mbi Inspektorati Shëndetësor 02L/38. Roli i tij është:

- Monitorimi i zbatimit të Ligjit të Shëndetësisë dhe të gjitha rregullativave ligjore që burojnë nga Ministria e Shëndetësisë, në sektorin publik dhe privat,
- Ushtron mbikëqyrjen e jashtme profesionale të Institucioneve Shëndetësore, pa marrë parasysh formën e financimit dhe pronësinë së tyre,
- Monitoron aktivitetet profesionale të Institucioneve Shëndetësore,
- Ofrimi i këshillave teknike lidhur me dispozitat ligjore dhe standardet.

Pas inspektimeve të bëra nga Inspektorati Shëndetësor numri i aplikusëve për licencim është shtuar dukshëm.

Në prill të vitit 2007 Inspektorati Shëndetësor duke krahasuar të dhënat nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë kombinuar me të dhënat nga Ministria e Shëndetësisë i ka identifikuar afro 500 IPSH që nuk kanë aplikuar për licencim, ndaj të cilave ka marr masën “Vendimit për mbyllje të përkohshme deri në aplikim”. Ato Institucione që nuk e respektojnë këtë masë do të ngritët kallëzim penal, proces i cili ka filluar.

Tema e studimi është “Ecuria e procesit të licencimit IPSH-ve gjatë periudhës gusht 2006 mars 2007”.

Për hulumtim kemi zgjedhur 4 regjione: Prishtinës, Pejës, Prizrenit dhe Gjilanit. Janë anketuar përmes pyetësorëve: 40 menaxherë që kanë aplikuar për licencim, 10 menaxherë që nuk kanë aplikuar për licencim dhe 120 pacient që marrin shërbime shëndetësore në IPSH.

Plotësimi i pyetësorëve nga menaxheret dhe pacientet është bërë në IPSH-të

III. FALËNDERIMET

Për kryerjen e këtij hulumtimi ka qenë i rëndësishëm bashkëpunimi me pacientët që trajtohen në këto institucione, menaxheret e Institucioneve Shëndetësore Private si dhe koleget. Punimi është bërë në konsultime permanente me Kryeinspektorin Shëndetësor. Një ndihmesë ka dhënë dhe konsultantantja e DIFD/HLSP, Anne Christine Hanser. Të gjithë i falënderojmë për kontributin e dhënë.

IV. QELLIMI I HULUMTIMIT

Studimi është bërë me qëllim të analizës së ecurisë së procesit të licencimit të Institucioneve Private Shëndetësore në Kosovë dhe arsyeja e mos aplikimit për licencim të disa Institucioneve.

V. HIPOTEZA

Dyshohet se disa Institucione Private Shëndetësore nuk aplikojnë për licencim për shkak të mos respektimit të ligjshmërisë si dhe ka dilema rreth cilësisë së shërbimeve shëndetësore të ofruara nga ana e IPSH-ve.

VI. SUPOZIMET

1. Nuk respektohet ligjshmëria nga disa Institucione Shëndetësore Private
2. Nuk ka kushte optimale për ofrimin e shërbimeve shëndetësore në disa IPSH
3. Institucionet Publike Shëndetësore shfrytëzohen nga disa profesionist mjekësor për rekrutimin e pacientëve
4. Pacientet nuk kanë njohuri të mjaftueshme për mundësin e ankesës



VII. METODOLOGJIA E PËRDORUR GJATË HULUMTIMIT



Që ky hulumtim të jetë profesional dhe objektiv janë përdorur këto metoda:

- Anketimi
- Krahasuese


VIII. ANALIZE E REZULTATEVE TE PYETËSORËVE

VIII/a. Analizë e pyetësorëve për pacient që marrin shërbimet shëndetësore në IPSH-të






Institucionin Shëndetësor më i preferuar për trajtim nga pacientët




Arsyet e pacienteve për përzgjedhjen e IPSH për trajtim:


- Mundësia për të zgjedhë mjekun sipas dëshirës.
- Nuk mungon terapia.
- ISH publike nuk janë të motivuara për pune.

Trajtimi i pacientëve më shumë se dy here në të njëjtin institucion gjatë 3 viteve të fundit







Rekomandimet e pacienteve për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore	Shprehur në Përqindje
Me pak pritje	43.33%
Me Shume informata	41.66%
Mjeket duhet t'u shpjegojnë pacienteve gjerat më fjalë më të kuptueshme	40.00%
E drejta ankesës	32.50
Me shume pastërti	29.16%
Mirësjellja e mjekut/infermiereve	25.00%
Me shume privatësi	23.33%




Opinionit i pacientëve për rëndësinë e licencimit e IPSH



Nëse IPSH nuk është e licencuar a do të kërkonit shërbim





Njohurit e pacientëve për ekzistencën e Inspektoratit




Opiniononi i pacientëve për Inspektoratin Shëndetësor.

- ISH-ja monitoron parregullsitë në IPSH dhe ato Publike si dhe ndihmon në ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore.
- Punojnë akoma pak në terren.
- Nuk kanë kompetenca të mjaftueshme.


VIII/b. Analize e Pyetësorëve për Menaxheret e IPSH –ve që kanë aplikuar për licencim






Komentet e menaxherëve në lidhje me menaxherët që udhëheqin institucion publik dhe privat paralelisht.

- Paraqet konflikt interesash.
- Pse jo është e nevojshme për shkak të kushteve ekonomike.




Komentet e menaxherëve lidhur me konkurrencën e IPSH të licencuara ndaj atyre publike.

- Ndikon në rritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore në të dy sektorët.
- Institucionet Private Shëndetësore nuk mund të jenë konkurrent për atë Publike sepse është e privilegjuar nga shteti.




Bashkëpunimi në mes institucioneve private dhe publike shëndetësore	Përqindja
Mirë	28.74%
Mesatarisht mirë	34.26%
Shumë i mirë	18.58%
Nuk kemi bashkëpunim	18.42%
Totali	100.00%




Rekomandimet e menaxherëve për mbështetje të Institucioneve Private nga Ministria e Shëndetësisë.


- Ndihmë e njëjtë si për publike dhe private nga ana e qeverisë psh. në: ngritje profesionale, dhënie e kredive, për blerje të aparaturave dhe pajisjeve mjekësore.
- Liberalizim i kushteve të licencimit.
- Shfrytëzim i sallave dhe pajisjeve mjekësore publike nga ato private kundrejt një shume simbolike.



Opinionet e menaxherëve për Institucionin Publik Shëndetësor	Përqindja
Partnere	82.50%
Konkurrente	10.00%
Nuk kam mendim	7.50%
Totali	100.00%




VIII/c. Analizë e Pyetësorëve për Menaxher e ISHP të Kosovës që nuk kanë Aplikuar për Licencim



Komentet e menaxherëve lidhur me mos pajisjen me legjislacion shëndetësor


- MSh-ja të përpilon infrastrukturen ligjore të nevojshme
- Disa menaxher mendojnë se MSH-ja duhet ti pajis me ligjet përkatëse
- Shkaqe financiare




Rekomandimi i menaxhereve:

- Kushtet dhe kriteret janë të ekzagjeruar
- Nuk kane kuadër të nevojshme për shërbimet që kryejnë (mungese e biokimistëve)


Njohurit për egzistimin e Ligjit për Praksën Private



Institucionet private të palicencuara a janë ilegale



Opinjoni i menaxherve që nuk kanë aplikuar, për kushtet e vëna për licencim



IX. ANALIZAT DHE STATISTIKAT E DOKUMENTACIONEVE TË ZASHMSH-ve dhe MTI


Në periudhën kohore 01.08.2006 deri me
31.03.2007

Kanë aplikuar për Licencim këto Institucione

Muaji	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Janar	Shkurt	Mars
Numri i aplikantëve	232	198	63	23	11	8	4	13
Përqindja	29.48%	24.39%	8.10%	3.13%	1.42%	0.83%	0.47%	0.95%
Totali i aplikanteve për këtë periudhë	552							
Perqindja	68.5 %							
Ne baze te dhënave nga MTI të regjistruar janë	773							

Nga të dhënat e statistikave të lartë shënuar shihet se kërkesat më të mëdha për aplikim të licencimit pranë ZASHMSH-ve përkatëse janë bërë në muajin gusht dhe shtator 06, afat i dhënë nga MSH-ja për aplikim si dhe pas daljes në terren të Inspektoratit Shëndetësor për inspektime.

IX/a. Analizë e të dhënave për gjendjen e procesit të licencimit në Kosovë gjer në maj 2007



XIII. KONKLUZIONET

1. Menaxheret dhe pacientët kanë opinion të mirë për procesin e licencimit.
2. Kërkohej që kushtet për licencim të jenë të njëjta si për sektorin privat edhe publik.
3. Pacientët, Institucionet Shëndetësore Private i përzgjedhin për shkak të: kushteve ma të mira për trajtim, sjellja e personelit, kohës së pritjes.
4. Kushtet e vëna nga MSH-ja për licencim mendohet se janë të egzagjeruara.
5. Duhet të merren masa ndaj institucioneve shëndetësore që nuk aplikojnë për licencim.
6. Ka shumë raste ku menaxheret e Institucioneve Publike punojnë në private dhe paraqitet si konflikt interesash.
7. Inspektorati Shëndetësor pranohet si organ që monitoron punën e Institucioneve Shëndetësore Publike dhe Private dhe se ndikon në ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore.
8. Pacientët me gjendje të mirë socio-ekonomike janë klient më të shpeshtë të IPSH-ve.
9. Një numër i konsideruar i pacientëve nuk dinë se ekziston mundësia ligjore për ankesë në rast të ofrimit jo adekuat të shërbimeve shëndetësore në IPSH.
10. Një numër i madh i pacientëve mendojnë se nëse IPSH-të në të cilat vizitohen nuk është i licencuar, nuk do të vizitohen prapë në këtë institucion.
11. Opinioni i përgjithshëm është se licencimi i IPSH-ve do të ndikoi në rritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, dhe po ashtu në rritjen e konkurrencës mes sektorit publik dhe privat.
12. Menaxherët e Institucioneve Private Shëndetësore, i konsiderojnë si partnere Institucionet Publike.
13. Menaxherët e Institucioneve që nuk kanë aplikuar për licencim deklarojnë se do të aplikojnë për licencim, dhe janë në dijeni që ushtrojnë veprimtari shëndetësore ilegale.
14. Një numër i madh i pacientëve rekomandohen në IPSH, nga mjekët që punojnë në sektorin publik.
15. Ligjshmëria nuk respektohet nga disa institucione shëndetësore.

XIII. REKOMANDIMET

1. Të respektohet ligjshmëria dhe të licencohet çdo veprimtari private sipas Ligjit mbi Veprimtarinë Private Shëndetësore dhe UA-të përkatëse.
2. Të merren masa për Institucionet që nuk aplikojnë për licencim.
3. Me një Urdhëresë Administrative të qartësohet angazhimi i menaxherëve të Institucioneve Publike në Institucione Private.
4. Institucionet Private Shëndetësore të pajisen me legjislaturë shëndetësore.
5. Të përpilohet UA për licencim të spitaleve dhe qendrave tjera publike.
6. Të ndërpritet praktika e rekrutimit të pacientëve në sektorin publik për atë privat.

XIV. REFERENCAT

- Ligji për shëndetësi i Kosovës 2004/4
- Ligji për Inspektoratin Shëndetësor të Kosovës 02L/38
- Ligji për veprimtarin private shëndetësore 2005/1
- UA mbi minimumin e kushteve teknike mjekësore, hapësira dhe personeli, sipas llojit të institucionit shëndetësor 2006/3
- UA për formimin dhe funksionimin e komisionit për vlerësimin e përmbushjes së kushteve teknike dhe profesionale për licencimin të institucioneve private 2006/2
- UA mbi pagesën e taksës administrative për licencimin e institucioneve e institucioneve shëndetësore 2006/1
- Listat e regjioneve nga ZASHMSH-të
- Lista nga MTI

XV. DOMETHËNIA E SHKURTESAVE

- MSH (Ministria e Shëndetësisë),
- ISH (Inspektorati Shëndetësor),
- IPSH (Institucion privat shëndetësor),
- MTI (Ministria e Tregtisë dhe Industrisë)
- ZASHMSH (Zyra e autoritetit shëndetësor i Ministrisë së Shëndetësisë në regjione)

XVI. PLANI I VEPRIMIT

Plani i punës për studim tematik:

Qershor

Java e pare: Plotësimi i pyetësorëve në dy qendra

Java e dyte: Analizimi i pyetësorëve për këto qendra

Java e trete: Plotësimi i pyetësorëve në dy qendra tjera

Java e katërt: Plotësimi i pyetësorëve dhe analiza e pyetësorëve

Korrik

Përpunimi përfundimtar i studimit tematik.

Kontakti me ZASHMSH-të, Pejë, Prishtinë, Prizren dhe Gjilan.

Data e përfundimit të studimit tematik 31.07.07.